

**VENDIM I**  
**ORTAKËVE**  
**TË**  
**“NOA DEVELOPMENT SHPK”**

Sot, më datë 05.04.2023, u mbajt mbledhja e ortakëve të **Noa Development**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (“**QKB**”), me numër unik identifikimi të subjektit (**NUIS**): L42203032I dhe seli në adresën: “*Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kati 2, Tiranë, Shqipëri*”. Pjesëmarrës në mbledhje ishin ortakët si vijojnë:

- **Gentian Sula**, shtetas shqiptar, lindur më 09.03.1983, mbajtës i pasaportës me numër personal I30309064B, i cili zotëron 0.06% të kapitalit të shoqërisë dhe;
- **Shoqëria Zip Cloud**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (“**QKB**”), me numër unik identifikimi të subjektit (**NUIS**): L61531022M, e cila zotëron 99.94% të kapitalit, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Eranda Nepravishta, shtetase shqiptare, lindur më 27.11.1974, mbajtëse e letërnjoftimit me numër 038401242, në cilësinë e administratorit të ZIP Cloud.

**Ortakët e shoqërisë që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit, pasi morën në shqyrtim pikat e rendit të ditës si me poshtë:**

- Diskutimin për transferimin e kuotës të zotëruar në Shoqëri, si kontribut të vlerësuar në para tek shoqëria Noa Holding Sh.p.k.me **NUIS: M31509039J**.
- Diskutimin për ndryshimin e nenit 5 të statutit të shoqërisë.

Për sa më sipër, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, të ndryshuar, ortakët e shoqërisë si vijon:

**VENDOSËN:**

1. Të transferojnë kuotat e tyre në Shoqëri, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerën 174.600.000,00 (*njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e gjashtëqind mijë*) Lekë, në formën e kontributit të vlerësuar në para në shoqërinë Noa Holding Sh.p.k.me **NUIS: M31509039J**.
2. Kuotat do të përfshihen në formën e kontributit të vlerësuar në para në kapitalin e shoqërisë Noa Holding Sh.p.k. në përputhje me vlerat e tyre nominale, siç gjenden aktualisht të regjistruara në Regjistrin Tregtar të mbajtur nga QKB. Si pasojë e këtij kontributi, ortaku i vetëm i Shoqërisë, do të jetë shoqëria Noa Holding Sh.p.k.

3. Në përputhje me sa më sipër, ndryshohet neni 5 i statutit të Shoqërisë, si vijon:

“Neni 5



**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 174.600.000,00 (njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e gjashtëqind mijë) i ndarë në 1 (një) kuotë që zotërohet 100% nga ortaku i vetëm, Shoqëria Noa Holding Sh.p.k.

4. Të depozitohen këtë vendim si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm pranë QKB dhe pranë të gjitha autoriteteve ku ky depozitim është i nevojshëm

**Ortakët e shoqërisë NOA DEVELOPMENT:**

**GENTIAN SULA**

**ZIP CLOUD**

**Eranda Nepravishta**